

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQËRISË "Clever Solutions" Sh.p.k.**

Sot, me datë 26/03 /2018,

- **Z. Gjergji Mulla**, i biri i Grigorit, lindur në Korçë, më 02/04/1979, banues në adresën: Rruga "Mujo Ulqinaku", Pallati Ndërtuesi 10, Sh.1, H.1D, Tiranë, mbajtës i dokumentit Kartë Identiteti me nr. personal H90402195J, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;
- **Z. Alkid Ademi**, i biri i Vullnetit, lindur në Shkodër, më 15/04/1979, banues në adresën: Rruga "Njazi Demi", Pallati 132, Shkalla 1, Tiranë, mbajtës i dokumentit Kartë Identiteti me nr. personal H90415156Q, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

Në përputhje me ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar) dhe ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", kanë vendosur të themelojnë një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar "Clever Solutions" Sh.p.k. (më poshtë referuar si "Shoqëria").

**NENI 1**

**EMËRTIMI**

Emri i Shoqërisë është "Clever Solutions" Sh.p.k.

**NENI 2**

**SELIA**

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga e Elbasanit, Pallati Gener 2, Kati i parë, Hyrja 2, 50 m sipër Fakultetit Ekonomik, Tiranë, Shqipëri.

Asambleja e ortakëve mund të themelojë filiale, seli dytësore ose njësi të tjera operative si dhe të transferojë selinë e shoqërisë në një adresë apo qytet tjetër.

**NENI 3**

**KOHËZGJATJA**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, përveç zgjatjes ose prishjes së mëparshme të saj sipas vendimit të Asamblesë së Ortakëve.

**NENI 4**

**OBJEKTI**

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj:

- Krijimin, zhvillimin dhe implementimin e programeve software, telekomunikacioni, teknologji informative të prodhuar prej saj ose personave të tretë. Realizimin e zhvillimit, shitjes dhe implementimin e tyre brenda dhe jashtë vendit.
- Import-eksport të paisjeve hardware elektronike, lëndës së parë, produkteve gjysëm të gatshme të ndërtimit dhe integrameve të sistemeve teknologjike.

Shoqëria mund të kryejë gjithashtu të gjitha operacionet tregtare, mbi pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, që do të vlerësohen të nevojshme apo të dobishme për realizimin e objektit të shoqërisë si dhe të blejë pjesëmarrje në kapitalin themeltar të shoqërive të tjera që kanë objekt të ngjashëm apo të përafërt me të vetin. Gjithashtu, brenda kufijve të përcaktuar nga ligji mund të lëshojë garanci, letra dëmshpërblimi dhe çdo garanci tjetër reale.

Shoqëria në ushtrimin e aktivitetit të saj, do të marrë të gjitha autorizimet e lejet e nevojshme pranë institucioneve publike shqiptare, dhe do të mbështetet në rregullat dhe normat në fuqi në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së saj të rregullt ekonomike.

## **NENI 5**

### **KAPITALI THEMELTAR**

Kapitali themeltar është i përbërë nga kontributet në të holla të ortakëve themelues në vlerën 1.000 000 Lekë (një milion Lekë) dhe është i ndarë në 2 kuota.

Kapitali themeltar ndahet si më poshtë:

- **Z. Gjergji Mulla**, zoteron 1 kuotë, me 50% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 500.000 Lekë (pesëqindmijë) dhe 500.000 Lekë (pesëqindmijë) të kapitalit themeltar.
- **Z. Alkid Ademi**, zoteron 1 kuotë, me 50% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 500.000 Lekë (pesëqindmijë) dhe 500.000 Lekë (pesëqindmijë) të kapitalit themeltar.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja në para ose në natyrë, sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve të marra më shumicat të parashikuara për ndryshimin e këtij statuti.

## **NENI 6**

### **ORGANET E SHOQËRISË**

Drejtimi i Shoqërisë kryhet nëpërmjet organeve të shoqërisë, të cilat janë:

-Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve; -Administratori/ët.

Asambleja e Përgjithshme do të jetë organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë.

Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. **Z. Alkid Ademi** caktohet Administrator i shoqërisë. Kohëzgjatja e mandatit të Administratorit është 5 (pesë) vjet, me të drejtë ri-emërimi.

## **NENI 7**

### **LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM**

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e statutit të shoqërisë, si dhe nga të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

## **NENI 8**

### **DISPOZITA FINALE**

Ky Akt Themelimi hartohet në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën shqipe.

Permbajtja e Aktit të Themelimit u lexua dhe nënshkrua nga Ortakët themelues të shoqërisë duke autorizuar Administratorin **Z. Alkid Ademi** për të kryer të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) në Tiranë.

### **ORTAKËT THEMELUES**

**GJERGJI MULLA**

**ALKID ADEMI**